

S'ka më dardanë në Ferizaj

faqe 4

MPB-ja fajtohet për zvarritjet në nxjerrje certifikatash

faqe 6

Diskutohet Plani Zhvillimor Urban në Lipjan

faqe 8

Brenda javës vidhen rreth 10 mijë euro ari

faqe 9



Lidhja Demokratike e Dardanisë
Democratic League of Dardania



ULPIANA

25.02.2013

Nr.9

Gazetë javore

Çmimi 0.20

Press

Më transparente Komuna, se që janë kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare

Y A H K

YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT



Faqe 5

Përurohet objekti i njësisë rajonale të ujësjellësit

faqe 4

Së shpejti guida turistike

faqe 11

Materiali steril i gurëve dëmton ambientin në Sillovi

faqe 6

Hakan Shykyr: Unë nuk jam turk, jam shqiptar

faqe 18



Press

YAHR organizon debat në Lipjan me temën "Transparenca dhe llogaridhënia" e institucioneve lokale

Më transparente Komuna, se që janë kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare

Daut Duriqi

Lipjan, 24 shkurt

Ndërsa qytetarët e kanë gojën plot kritika për mungesë transparence të organeve komunale, në bazë të dhënave del se interesimi i tyre për të pasur qasje në dokumentet zyrtare është shumë më i vogël se sa janë ankesat e tyre. Këto të dhëna kanë dalur nga një debat të organizuar të premtën nga Asociacioni Rinor për Drejtat e Njeriut (YAHR) me temën "Transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve lokale". Numri prej gjithsej 16 kërkesave për të pasur qasje në dokumentet zyrtare për gjithë vitin 2012, së paku për aq sa është raportuar, dëshmon përgjumjen e qytetarit për të kërkuar një të drejtë ligjore dhe kjo aq më parë që pjesa më e madhe prej 16 kërkesave, 9 prej tyre janë shtruar nga gazetarët, ndërsa vetëm 2 janë nga qytetarët. Në këtë aspekt del se hiq më keq se qytetarët të mos jenë as ata që i përfaqësojnë, këshilltarët komunalë. Edhe pse në debatin e YAHR-it ishin të ftuar këshilltarë pozitivë e opozitarë, Sefer Tasholli sekretar nga Dega e LDK-së në Lipjan, ka qenë i vetmi opozitar që ka dalë përballë kryetarit të kësaj komune, Shukri Buja, në debatin e organizuar të premtën nga Asociacioni Rinor për Drejtat e Njeriut (YAHR) me temën "Transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve lokale". Në takim pos opozitarëve, ndërkaq mungonte edhe kryesuesi i KK-së, Lulzim Rustemi. Por, takimin e kanë refuzuar edhe autoritetet komunale të Ferizajt, derisa Shtimja është përfaqësuar vetëm nga zyra e informacionit publik. Ndryshe, nikoqiri i takimit, Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR, ka deklaruar se ndien keqardhje pse një numër i madh këshilltarësh opozitarë dhe të pozitës refuzuan debatin për një çështje të ndjeshme. "Shprehim keqardhje për ata që s'erdhën, por megjithatë po e nisim debatin edhe



ashtu siç jemi", ka thënë në fillim Krasniqi, për të rekomanduar më vonë një notë protestë për ata që nuk morën pjesë. I pakënaqur pse nuk kishte përballë më shumë pjesëtarë të opozitës u shfaq edhe kryetari i Lipjanit, Shukri Buja. "Pjesëmarrja në këtë debat do të duhej të ishte më ndryshe, sepse këto takime ndihmojnë jo vetëm për të shqyrtuar transparencën, por edhe për të operuar më mirë në Komunë", ka thënë Buja. Duke folur për transparencën, kreu komunal ka thënë se gjatë vitit 2012 në adresë të komunës që drejton ka pasur 16 kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare, ndërsa prej këtij numri, sipas Bujës, 9 prej kërkesave janë shtruar nga gazetarët, 5 nga studentët dhe vetëm dy nga qytetarët. Buja tha se në 12 kërkesa Komuna ka dhënë përgjigjen, derisa 4 të tjera janë refuzuar për mos definim të subjektit dhe adresim të gabuar. "Sa i përket transparencës në komunën e Lipjanit, ajo është në nivelin më të lartë të mundshëm. Pra, gjithë qytetarët, shoqëritë civile, mediat cdo ditë pune mund të vijnë në Komunë për të kërkuar cilindo dokument apo vendim që ka marrë Komuna, andaj për mosinteresimin e qytetarëve për të kërkuar qasje në dokumentet zyrtare faji nuk është te Komuna.", ka thënë Buja. Në këtë aspekt del se hiq më keq se qytetarët të mos jenë as ata që i përfaqësojnë, këshilltarët komunalë.

Sefer Tasholli, njëherësh edhe shef i grupit parlamentar të LDK-së në Kuvendin Komunal, thotë se vetë këshilltarët nuk i ndjekin ato procedurat që duhet me i ndjekë, normat ligjore për të kërkuar diçka. "Nëse në ndërkohë na bie diçka ndërmend, apo na thotë rrugës dikush diçka derisa sa të vijmë në kuvend, dhe ashtu të papërgatitur ngrisim dorën për të diskutuar, kërkojmë diçka dhe masandej dikush akuzon pse nuk e ka marrë përgjigjen, edhe pse nuk e bën kërkesën ashtu si duhet", ka thënë Tasholli. Ndërkaq, kryetari Buja, si të metë të qytetarëve ka përmendur edhe mospjesëmarrjen në debate publike, siç është diskutimi publik për buxhetin, rregulloret për planin zhvillimor etj. "Unë me stafin tim çdoherë kemi mbajtur takime me publikun për shumë çështje me rëndësi për vetë qytetarët. Për projekt-buxhetin janë organizuar takime me qytetarët, si dhe për pro-

jekte të tjera. Mirëpo, kur jemi këtu, habit fakti sesi aspak nuk shprehin gatishmëri qytetarët për të marrë pjesë në këto debate", ka thënë Buja, duke përmendur si ilustrim një rast interesant në Magurë, ku në një debat të organizuar nga Komuna, me insistimin e banorëve të atjeshëm, kishte marrë pjesë vetëm një qytetar. "Kërkesa për debat ishte bërë më arsyetimin për papunësi të banorëve të Magurës, ndërsa përgjigja e qytetarit të vetëm pjesëmarrës ishte se qytetarët tjerë mungojnë në debat për shkak se janë në vendet e tyre të punës", tha Buja. Nga ana tjetër, Sefer Tasholli, sekretar në LDK, Dega e Lipjanit, ka shtruar nevojën e gjetjes së mekanizmave për të ardhur deri te një kontakt i qëndrueshëm mes qytetarit dhe Komunës. "Përveç kuvendit dhe Komiteti për Politikë dhe Financa ku jam anëtar i tij, është i hapur për të gjithë ata që dëshirojnë me ditë se çka bëhet. Takimet publike që janë të parapara me ligj ato mbahen. Jemi munduar pozitivë e opozitë bashkërisht të marrin pjesë të marrim edhe ne si grupe parlamentare nëpër takime publike që i kemi organizuar, t'i njoftojmë ata për takimin që do të mbahet në sallën e Kuvendit Komunal në Lipjan. Mirëpo, ka qenë një fatkeqësi që kanë marrë pjesë një numër shumë i vogël i tyre dhe shpeshherë ka ndodhur që më shumë të jemi ne këshilltarët dhe organet komunale se sa që kanë ardhur qytetarë", ka thënë Tasholli.

Tasholli kërkon përkrahje për gazetën "Ulpiana Press"

"Ka tetë numra që ka filluar të dalë në botim gazeta "Ulpiana Press" dhe me ende i lexoj të gjithë artikujt në gazetë, të cilët janë edhe për Ferizaj dhe Shtime. Pra, nuk më mbetet asnjë shkrim pa e lexuar, prandaj kjo formë e informimit mund të jap kontribut shumë të madh, andaj duhet që tri komunat mes veti të gjejnë formën e donacionit në mënyrë që këtë gazetë me e mbajtur gjallë. Një medium i pavarur që pasqyron realitetin në teren dhe e hapur për gjithë opinionin..Prandaj, që nga dita e parë e deri më sot të tillë po e shoh këtë medium të shkruar lokal", ka thënë shefi i grupit parlamentar të LDK-së, Sefer Tasholli.